



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Page |
1

PROJEKTRREGULLORE

Nr. __, datë __. __. 2025

Për

**“Procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore
që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen
e tregut të komunikimeve elektronike
dhe shërbimeve postare”**

Dokument për Këshillim Publik

(Miratuar me VKD nr.12, datë 27.08.2025)

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurës për mënyrën e llogaritjes dhe kryerjes së pagesës vjetore në AKEP, për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe tregut të shërbimit postar.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i rregullores është garantimi i plotësimit të nevojave për financimin e AKEP për ushtrimin e veprimtarisë si organ kompetent në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, nëpërmjet pagesave për mbikëqyrjen e tregjeve respektive, që duhet të kryejnë sipërmarrësit dhe ofruesit e shërbimeve postare në përputhje me përcaktimet ligjore.

Neni 3 Baza Ligjore

3.1. Rregullorja dhe dispozitat për përcaktimin e procedurës dhe mënyrës së llogaritjes të nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të:

- a) *komunikimeve elektronike, bazohet në pikën 1 të nenit 17, pikën 1, germën a, të nenit 19, nenin 20, dhe nenin 36 të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,*
- b) *shërbimit postar, bazohet në nenin 27 të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.*

Neni 4 Parimet e zbatueshme

4.1. Pagesat vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe tregut të shërbimit postar që sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimit elektronik dhe ofruesit e shërbimit postar, duhet të paguajnë në AKEP, nuk duhet të çenojnë konkurrencën apo krijojnë pengesa për hyrjen në treg të subjekteve të rinj të interesuar për të ushtruar aktivitet tregtar në tregjet respektive sipas përcaktimeve ligjore.

4.2. Pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe tregut të shërbimit postar duhet të kryhet nga sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimit dhe ofruesit e shërbimit postar, për të mbuluar në mënyrë të ndarë kostot administrative të AKEP, për ushtrimin e

veprimtarisë si organ rregullator në secilën nga fushat referuese.

Neni 5

Kufiri i nivelit të pagesës për mbikëqyrjen e tregut

Pagesa vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar, në çdo rast, për secilin sipërmarrës dhe ofrues të shërbimit postar, nuk duhet të jetë më e lartë se niveli në përqindje mbi bazën e së ardhurës vjetore të realizuar në vitin kalendarik të mëparshëm, i përcaktuar veçanërisht në ligjin që rregullon marrëdhëniet në fushën e komunikimeve elektronike dhe ligjin për shërbimet postare.

KREU II

DISPOZITA PROCEDURIALE

Neni 6

Dorëzimi i pasqyrave financiare dhe i bilancit vjetor

- 6.1. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe ofruesit e shërbimeve elektronike dhe postare, subjekte të detyrimit të pagesës për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar, me qëllim vërtetimin e të ardhurës vjetore të realizuar nga veprimtaria në fushën përkatëse, brenda afatit të përcaktuar në këtë rregullore, depozitojnë në AKEP, sipas përgjegjësisë tatimore, si më poshtë:
- a) *Kopje të bilancit vjetor të depozituar në organin kompetent tatimor sipas legjislacionit në fuqi;*
 - b) *Kopje të raportit të ekspertit kontabël të autorizuar, të depozituar në organin kompetent tatimor sipas legjislacionit në fuqi;*
 - c) *Kopje të Pasqyrave financiare të audituara;*
 - ç) *Kopje të Formularit të Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi Fitimin sipas legjislacionit në fuqi;*
 - d) *Deklaratën e subjektit mbi të ardhurën vjetore të vitit të mëparshëm, realizuar nga veprimtaria në fushën e komunikimeve elektronike dhe/ose të shërbimit postar. (Deklarimi i rremë me qëllim mashtrimin dhe shmangien e përllogaritjes reale të detyrimit kur nuk përbën kundërvajtje administrative konsiderohet vepër penale).*
- 6.2. Dokumentacioni i kërkuar sipas pikës 6.1 të këtij neni, dërgohet nga subjekti, në rrugë elektronike, në adresën info@akep.al dhe/ose shkresore dhe në sistemin e-Aplikime, në faqen zyrtare të AKEP.
- 6.3. Afati përfundimtar i depozitimit në AKEP i dokumentacionit sipas pikës 6.1 të këtij neni, për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, është i njëkohshëm me atë të përcaktuar në legjislacionin tatimor në fuqi për depozitimin në organin tatimor të bilancit vjetor të subjektit.
- 6.4. Afati përfundimtar i depozitimit në AKEP i dokumentacionit sipas pikës 6.1 të këtij neni, për ofruesit e shërbimit postar, është në zbatim të ligjit për shërbimet postare në fuqi.
- 6.5. Me qëllim llogaritjen në kohë të pagesës për mbikëqyrjen e tregut nga AKEP dhe kryerjes së kësaj pagese nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe ofruesit e shërbimit postar brenda afateve ligjore, AKEP, brenda datës 15 shkurt të vitit korrent, në rrugë elektronike dhe/ose shkresore, njofton

të gjithë subjektet që mbartin detyrimin e pagesës së mbikëqyrjes së tregut, për depozitimin në AKEP të:

- a) *“Deklaratës paraprake mbi të ardhurën vjetore të realizuar nga veprimtaria në fushën e komunikimeve elektronike dhe/ose shërbimit postar për vitin e mëparshëm”;*
- b) *Dokumentacionit sipas pikës 6.1 të nenit 6 të kësaj rregulloreje.*

- 6.6. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe ofruesit e shërbimit postar, jo më vonë se data 15 mars e vitit korrent, depozitojnë në rrugë elektronike në adresën info@akep.al, shkresore dhe në sistemin e-Aplikime në faqen zyrtare të AKEP, *“Deklaratën paraprake mbi të ardhurën vjetore të realizuar nga veprimtaria në fushën e komunikimeve elektronike dhe/ose shërbimit postar për vitin e mëparshëm”*, sipas modelit bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
- 6.7. Të dhënat e deklaruara paraprakisht nga subjekti sipas pikës 6.6, të këtij neni, duhet të përputhen me të dhënat e pasqyruara në bilancin vjetor që dorëzohen në organin tatimor. Në rast mospërputhje, subjekti deklarues mban përgjegjësi për pasojat dhe kryhen korrigjimet sipas parashikimeve ligjore për saktësinë e të dhënave të vetdeklaruara.
- 6.8. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe ofruesit e shërbimit postar, mbartës të detyrimit të pagesës së mbikëqyrjes së tregut sipas kësaj rregulloreje, kanë detyrimin ligjor që edhe pa u njoftuar më parë nga AKEP-i, sipas pikës 6.5, të këtij neni, të depozitojnë, dokumentacionin sipas pikës 6.1 të nenit 6, të kësaj rregulloreje.
- 6.9. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe ofruesit e shërbimit postar, të cilët ushtrojnë një ose disa aktivitete të tjera të ndryshme nga komunikimet elektronike dhe shërbimi postar, duhet të zbatojnë, ndarjen e llogarive, për të evidentuar të ardhurat që vijnë nga komunikimet elektronike dhe shërbimet postare si zë më vete dhe të ndara nga të ardhurat që vijnë nga aktivitete të tjera të biznesit.

Neni 7

Llogaritja e nivelit të pagesës vjetore

7.1. Llogaritja e nivelit të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar, kryhet nga AKEP-i mbi bazën e formulës së përcaktuar në këtë rregullore dhe të dhënave që administron AKEP për të ardhurat e siguruara nga secili subjekt që mbart detyrimin e kësaj pagese, si dhe të shumës së shpenzimeve për mbulimin e kostove administrative të AKEP për vitin korrent për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe atë të shërbimit postar, të ndarë veçmas për secilin zë, sipas planit të shpenzimeve të miratuar nga Këshilli Drejtues i AKEP.

7.2. Afati i llogaritjes nga struktura përgjegjëse e AKEP, të nivelit të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar, është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga momenti i përllogaritjes të nivelit të pagesës vjetore të shprehur në përqindje referuar realizimit të të ardhurave të vitit të mëparshëm të rezultuara nga depozitimi i pasqyrës financiare nga subjekti që mbart detyrimin e pagesës së mbikëqyrjes së tregut, të dokumentacionit sipas pikës 6.1 të nenit 6 të kësaj rregullore.

7.3. Mosdepozitimi i dokumentacionit sipas pikës 6.1 të nenit 6 të kësaj rregulloreje, nga

sipërmarrësit, nuk përbën pengesë për AKEP, që të llogarisë dhe përcaktojë kryesisht nivelin e pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut mbi bazën e të dhënave të vitit paraardhës, të depozituara nga ky subjekt për këtë qëllim.

Neni 8

Faturimi dhe Pagesa

- 8.1. AKEP, me përcaktimin e nivelit të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar, i dërgon çdo sipërmarrësi të komunikimeve elektronike dhe ofruesi të shërbimit postar, në rrugë elektronike dhe/ose shkresore, faturën elektronike të fiskalizuar për pagesën e mbikëqyrjes së tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar. Në rast mosrefuzimi të faturës, brenda 30 ditëve nga data e dërgimit, fatura do të konsiderohet titull ekzekutiv.
- 8.2. Subjektet që mbartin detyrimin e kryerjes së pagesës së mbikëqyrjes së tregut sipas kësaj rregullore, pas dërgimit të faturës nga AKEP, duhet të kryejnë pagesën në llogaritë bankare të AKEP brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit.
- 8.3. Pagesa vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar, kryhet në llogaritë bankare të AKEP, të specifikuara në faturën e njoftuar.

KREU III

DISPOZITA MATERIALE

Neni 9

Formula e llogaritjes së nivelit të pagesës vjetore

- 9.1. Niveli i pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar, përcaktohet në përqindje dhe është i barabartë respektivisht për secilin sipërmarrës të komunikimeve elektronike dhe ofrues të shërbimit, që mbart detyrimin e kësaj pagese.
- 9.2. Niveli i pagesës vjetore për mbikëqyrje të tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar, llogaritet nga struktura përgjegjëse në AKEP, e cila informon Këshillin Drejtues të AKEP.
- 9.3. Niveli i pagesës vjetore do të jetë në çdo rast brenda kufirit prej 0.5% të së ardhurës vjetore të realizuar vitin e mëparshëm nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe ofruesit e shërbimit postar.
- 9.4. Niveli i pagesës vjetore për secilën nga pagesat për mbikëqyrjen e tregut, llogaritet me formulën:

$$\text{NPV} = \frac{\text{KAdV}}{\text{AV}} \cdot 100$$

NPV - Niveli i pagesës vjetore në përqindje (%) i veçantë sipas secilit rast, për mbikëqyrjen e tregut

të:

- komunikimeve elektronike;
- shërbimit postar.

KAdV - Kosto administrative vjetore e AKEP e planifikuar për vitin korrent për mbikëqyrjen veçmas për secilin nga tregjet (komunikimeve elektronike dhe postare), që do të financohet respektivisht nga pagesat për mbikëqyrjen e tregut të:

- komunikimeve elektronike;
- shërbimit postar.

të përcaktuara në Planin vjetor të shpenzimeve të AKEP miratuar nga Këshilli Drejtues.

AV - Shuma e të ardhurave vjetore të vitit paraardhës e realizuar veçmas nga veprimtaria në secilin nga tregjet prej:

- sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike për komunikime elektronike;
- ofruesve të shërbimit postar.

Neni 10

Llogaritja e pagesës vjetore

10.1. Pagesa vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe tregut të shërbimit postar që duhet të kryejë çdo sipërmarrës dhe/ose ofrues i shërbimit postar për vitin korrent, llogaritet nga struktura përgjegjëse në AKEP sipas formulës:

$$PV = AVS \times NPV$$

PV - Pagesa vjetore që do të kryhet nga secili:

- sipërmarrës për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike;
- ofrues i shërbimit postar për mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar.

AVS - Të ardhurat vjetore sipas pasqyrave financiare vjetore të vitit paraardhës, të secilit:

- sipërmarrës të komunikimeve elektronike;
- ofrues të shërbimit postar për mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar.

NPV - Niveli i pagesës vjetore korrente, në përqindje (%), për mbikëqyrjen e tregut të:

- komunikimeve elektronike;
- shërbimit postar.

i llogaritur sipas formulës të përcaktuar në nenin 9 të kësaj rregullore për mbulimin e kostove administrative të AKEP për mbikëqyrjen e secilit nga tregjet e sipërcituara.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 11 Kundërvajtjet administrative

- 11.1 Moskryerja e pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, nga ana e sipërmarrësit, brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë sipas përcaktimeve të parashikuara në pikën 1, germa c/xii, të nenit 184 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
- 11.2. Moskryerja e pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut postar, nga ana e ofruesit të shërbimit postar, brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë sipas përcaktimeve të pikës 1, germa c/ii, të nenit 61 të në ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”.
- 11.3. Mosrespektimi i detyrimeve sipas nenit 36 të ligjit 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë sipas përcaktimeve të pikës 1, germa a/ii, të nenit 184 të po këtij ligji.

Neni 12 Shfuqizime

Rregullorja e AKEP, nr. 20, datë 18.12.2015 “*Mbi procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare*”, shfuqizohet.

Neni 13 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Këshilli Drejtues i AKEP.

**DEKLARATË MBI TË ARDHURËN VJETORE TË VITIT 20___, REALIZUAR NGA
VEPRIMTARIA NË FUSHËN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE**

Emri i subjektit:

NIPT:

Datë: __. __. 20__

Nr.	Emri i Subjektit	Vlera në lek
	Viti 20__	
1	Të ardhurat totale	0
2	Të ardhura të realizuara nga ofrimi i rrjeteve dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike	0

Emër Mbiemër/ Firmë/ Vulë/

**DEKLARATË MBI TË ARDHURËN VJETORE TË VITIT 20__, REALIZUAR NGA
VEPRIMTARIA NË FUSHËN E SHËRBIMEVE POSTARE**

Emri i subjektit:

NIPT:

Datë: __.__.20__

Page |
9

Nr.	Emri i Subjektit	Vlera në lek
	Viti 20__	
1	Të ardhurat totale	0
2	Të ardhura të realizuara nga veprimtaria në fushën e shërbimeve postare	0

Emër Mbiemër/ Firmë/ Vulë/